

LIGJ
Nr. 10 306, datë 22.7.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8668, DATË 23.11.2000 “PËR
PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Emërtimi “Ministria e Rendit Publik”, në të gjitha rastet ku është përdorur, zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Brendshme”.

Neni 2

Në fund të nenit 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në elementet e sigurisë përfshihen të dhënat biometrike, përmbajtja e të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Në nenin 3, paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 4

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Procedura e aplikimit dhe dokumentet që paraqiten për aplikim përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Brendshme.”.

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Pasaporta e zakonshme tërhiqet pranë drejtorive dhe komisariateve të policisë. Tërheqja e pasaportës kryhet nga shtetasi ose i ngarkuari me prokurë të posaçme apo një pjesëtar i afërt i familjes (bashkëshortja/prindi, fëmija madhor) apo kujdestari ligjor për të miturit dhe për shtetasit

pa zotësi për të vepruar.

Pasaporta e shërbimit dhe ajo diplomatike tërhiqen pranë zyrës përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme.”.

Neni 6

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të paragrafit të parë shtohen fjalët:
“kur ndryshojnë përbërësit e gjendjes civile.”.
2. Në paragrafin e dytë, fjalët “nga pakujdesia e mbajtësit të saj” hiqen.

Neni 7

Neni 12 shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 13, fjalët “dhe sistemi i lëshimit” hiqen.

Neni 9

Dispozitë kalimtare

Pasaportat e vlefshme jobiometrike mund të nxirren nga qarkullimi përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Tarifat për pajisjen dhe ripajisjen me pasaportë biometrike janë të përcaktuara në kontratën koncesionare, ratifikuar me ligjin nr.9972, datë 28.7.2008. Me përfundimin e kësaj kontrate, këto tarifa do të përcaktohen me akte ligjore dhe nënligjore.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6660, datë 30.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**